5	Veprimi 2.5 Publikimi i të dhënave mbi nxënësit e riintegruar në shkollat, kurset e mbajura, testet shkollore të shpërndara	Vazhdimisht	ZKKK,DKA	BKK

Shënim: BKK-Buxheti i konsoliduar i Kosovës, për këto veprime ndahen fonde nga MASHT-i

Aktiviteti 3: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Organizmi i fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë	2023 -2025	ZKKK-DKA	BKK
2	Veprimi 3.2 Identifikohen nevojat e nxënësve që nuk vijojnë mësimin me rregull	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
3	Veprimi 3.3 Ofrohen programe mësimi joformale intensive për nxënësit që kanë braktisur shkollën në nivelin fillor dhe të mesëm	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
4	Veprimi 3.4 Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
5	Veprimi 3.5 Ofrohen orë plotësuese në shkollat për gjuhë romë dhe lëndë tjera të nevojshme nëse ka.	Vazhdimisht	DKA	BKK
6	Veprimi 3.6 Caktohen mesimdhënësit që punojnë me nxënësit me vështirësi në të nxënë përkatësisht në orë plotësuese	2023		

Aktiviteti 4. Krijimi i kushteve për vazhdimin e arsimit pas shkollimit të obligueshëm		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Themelimi i fondit për bursa	2023	DKA	BKK
2	Veprimi 4.2 Themelimi i komisionit të përbashkët të përbërë prej komuniteteve, institucioneve dhe organizatave për ndarjen e bursave	2023	DKA-ZKKK-OJQ	BKK
3	Veprimi 4.3 Organizohen fushata ndërgjegjësimi për vazhdimin e shkollimit	2023-2025	DKA-ZKKK-OJQ	BKK
4	Veprimi 4.4 Ofrohen kurse përgatitore gjatë vitit shkollor për regjistrim në shkollën e lartë, për nxënësit me rezultate të dobëta	2023-2025	DKA-ZKKK	BKK

Aktiviteti 5. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor		Periudha	Bartës	Buxheti
--	--	----------	--------	---------

1	Veprimi 5.1 Identifikohen fëmijët me nevoja të veçanta	2023 dhe vazhdimisht	ZKKK-DKA	BKK
2	Veprimi 5.2 Raportimi dhe koordinimi i punës me MASHT-in për veprimet e mëtutjeshme	Vazhdimisht	DKA	BKK

Aktiviteti 6. Parandalimi i dallimeve etnike dhe mos diskriminimi me akte ligjore		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 6. Raportimi i shkollave për rastet e raportuara të segregacionit ose anashkalimit	Vazhdimisht	DKA	BKK
2	Veprimi 6.2 Adresim dhe zgjedhje e rasteve të raportuara	Vazhdimisht	DKA	BKK
3	Veprimi 6.3 Në bashkëpunim me MASHT-in, ofrohen trajnime për mësime për mësimdhënës për mënyrën e parajgjyqimeve	Vazhdimisht	DKA-MASHT	BKK

Objektivi 2: Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe organizata relevante në funksion të arsimit të pjestarëve të komuniteteve Rom , Ashkali dhe Egjiptian				
Aktiviteti 1: Aktivitete të përbashkëta me policinë e komunitetit lidhur me sigurinë		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Bashkëpunim me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi.	2023-2025	DKA-ZKKK	BKK
2	Veprimi 1.2. KKS identifikon rastet që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë së nxënësve në shkolla	Vazhdimisht	DKA	BKK
3	Veprimi 1.3 DKA lidh marrëveshje bashkëpunimi me policinë e komunitetit lidhur me ofrimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Element të marrëveshjes janë patrullimi i rregullt, në afërsi të shkollave.	2023 Vazhdimisht	DKA-PK	BKK
4	Veprimi 1.4 DKA, shkollat dhe policia e Kosovës hartojnë planin e veprimit	2023-2025	DKA-PK	BKK
5	Veprimi 1.5 Mbahen takime të rregullta tremujore në mes DKA-shkollave , PK dhe përfaqësuesve të komuniteteve.	Vazhdimisht	DKA-ZKKK-PK	BKK
6	Veprimi 1.6 Hartohen dhe publikohen raportet tremujore	Vazhdimisht	DKA-PK	BKK

Aktiviteti 2. Masat për mosrespektim të Ligjit mbi shkollimin e obliguar		Periudha	Bartës	Buxheti
---	--	----------	--------	---------

1	Veprimi 2.1 Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijojnë shkollën rregullisht	vazhdimisht	DKA-ZKKK	BKK
2	Veprimi 2.2 Organizohen takime informative me komunitete në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar	2023-2025	DKA-ZKKK	BKK
3	Veprimi 2.3 Ndërmerren masa ligjore ndaj stafit të shkollës që nuk raporton me kohë rastet e braktisjes dhe mosvijueshmërisë.	vazhdimisht	DKA	BKK

Aktiviteti 3: Ofrohen programe ekzistuese për zvogëlimin e shkollës së analfabetizimit - përkrahje		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Identifikohen partnerët që ofrojnë programe të licensuara kundër analfabetizimit	2023	DKA-ZKKK	
2	Veprimi 3.2 Identifikohen individët që nuk kanë vijuar shkollën	2023	DKA-ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Organizohen takime me grupet e identifikuar me qëllim të informimit për mundësitë lidhur me zhdukjen e analfabetizimit	2023	DKA-ZKKK	
4	Veprimi 3.4 Në kuadër të qendrave të komunitetit të organizohen kurse vetëm për femra	2023	DKA-ZKKK	

Aktiviteti 4: Krijimi i qendrës burimore në nivel komunal		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Ofrohen orë plotësuese për nxënësit e shkollave filllore	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
2	Veprimi 4.2 Kurse të ndryshme për pjesetare të komunitetëve rom, ashkalinje dhe egjiptian	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
3	Veprimi 4.3 Ofrojnë programe për zhdukjen e analfabetizimit	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
4	Veprimi 4.4 Përfshirja e prindërve në aktivitete të Qendrës.	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
5	Veprimi 4.5 Krijimi i këshillit të prindërve të nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinje dhe egjiptian	Vazhdimisht	DKA-ZKKK	
6	Veprimi 4.6 ZKKK lehtëson koordinimin e punëve të KPNRAE me KPA	Vazhdimisht	DKA-ZKKK KPA	

Këshilli i prindërve të Nxënësve të Komuniteteve ROM, Ashkali dhe Egjiptian

Këshilli i prindërve dhe arsimtarëve

Aktiviteti 5: Organizohen aktivitete kulturore sportive		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Formohet grupi kulturor i shkollës në përbërje të mësimeve të mesme , nxënësve dhe prindërve		DKA-shkolla ZKKK	Nuk kërkohen
2	Veprimi 5.2 Formohen grupet sportive në shkollë në formë të klubeve sportive	2023	DKA-shkolla ZKKK	Nuk kërkohen
3	Veprimi 5.3 Hartohet plani shkollor për aktivitete kulturore dhe sportive me karakter multi-etnik	2023	DKA-shkolla grupet e formuara	Nuk kërkohen
4	Veprimi 5.4 Caktohen përgjegjësit për realizimin e aktiviteteve sipas planit të hartuar		DKA-shkolla grupet e formuara	
5	Veprimi 5.5 Caktohet buxheti për aktivitete e parapara në planin e hartuar		DKA-shkolla grupet e formuara	
6	Veprimi 5.6 Organizohen aktivitetet kulturore në përputhje me interesat e komunitetit	vazhdimisht në bazë të planit të hartuar	DKA-shkolla grupet e formuara	DKRS, DKA

SHËNDETËSIA

Qëllimi: Përmirësimi i statusit shëndetësor dhe social, dhe cilësisë së shërbimit dhe qasjes ndaj sistemit shëndetësor dhe social të Kosovës, pa diskriminim të tri komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Objektivi 1: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjeno-sanitare dhe mjedis i përshtatshëm dhe i shëndetshëm në vendbanimet e komuniteteve jo shumicë në ngitjen dhe cilësinë e kualitetit të jetës së tyre

Aktiviteti 1: Ndërmarrja e aktiviteteve për përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare , të mjedisit dhe praktikave dhe sjelljeve relevante		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Sigurimi i ujit të pijshëm, kanalizimeve dhe vendeve të caktuara për hedhjen e mbeturinave dhe të rrjetit elektrik në lagjet e Komuniteteve jo shumicë	vazhdimisht	Komuna ZKKK- MPMS	
2	Veprimi 1.2 Ofrimi i programeve trajnuese dhe edukative për shëndetin dhe higjenën personale	vazhdimisht	ZKKK- DSHMS	
3	Veprimi 1.3 Institucionalizimi i pozitës së ndërmjetësit shëndetësor		DSHMS,ZKK 2023 K ,OJQ-të	

Objektivi 2: Mundësimi i marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacionit, përfshirjes në skemat e ndihmës dhe ofrimit të shërbimeve në formë të barabartë dhe në përputhje me nevojat

Aktiviteti 2. Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ndërgjegjësimit, informimit dhe përfshirjes në skemat ekzistuese.		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Informimi i komuniteteve për mundësitë e marrjes dhe llojeve të shërbimeve	vazhdimisht	ZKKK-QPS	
2	Veprimi 2.2 Ofrimi i ndihmave sociale për komunitetet jo shumicë	vazhdimisht	MPMS	BKK

	Veprimi 2.3 Lehtësime në obligimet komunale për familjet që nuk kanë ndihmë sociale dhe asnjë formë tjetër të të ardhurave	vazhdimisht	ZKKK	
--	--	-------------	------	--

Objektivi 3: Vlerësimi i kushteve i dijenisë shëndetësore të tri komuniteteve përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave të qëndrueshme dhe të besueshme.

Aktiviteti 3:Përmirësimi i qasjes së tri komuniteteve ndaj sistemit shëndetësor dhe përdorimit efektiv të tij përmes informimit dhe fushatave ndërgjegjësuese		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprim 3.1 Mbatja e fushatave për imunizim, sistemit shëndetësor, riciklimin e mbeturinave etj.	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
2	Veprimi 3.2 Mbatja e takimeve në komunitete për informim dhe rritjen e dijenisë mbi të drejtat për shërbimet e ofruara mjekësore	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Vaksinimi i detyrueshëm i të gjithë fëmijëve nga mosha 0-14 vjeç	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK-OJQ	
4	Veprimi 3.4 Trajnimi dhe aftësimi i nënave për një kujdes të shtuar gjatë kohës së shtatzanisë, kontrollave të rregullta mjekësore.	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	
5	Veprimi 3.5 Të jetë kujdes parësor për nënat dhe fëmijët para, gjatë dhe pas lindjes	vazhdimisht	DSHMS-QKMF-ZKKK	

Objektivi 4: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjieno-sanitare dhe mjedis i shëndetshëm në vendbanimet e komuniteteve jo shumicë

Aktiviteti 4:Përmirësimi i qasjes së tri komuniteteve ndaj sistemit shëndetësor dhe përdorimit efektiv të tij përmes informimit dhe fushatave ndërgjegjësuese		Periudha	Bartës	Buxheti
--	--	----------	--------	---------

1	Veprim 4.1 Të mbahen takime sistematikisht në edukimin shëndetësor në grupe dhe bashkësi si dhe në sigurimin e kushteve dhe praktikave tjera në kontest të ruajtjes së shëndetit dhe qasje të ekipeve mjekësore ndaj komuniteteve gjithëherë kur kanë qenë të nevojshme	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
2	Veprimi 4.2 Vazhdimisht të mbahen trajnime dhe fushatë për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar, në imunitet në trajtimin e sëmundjeve dhe parandalimin e anemive dhe infeksioneve, parazitëve të zorrëve, tuberkulozit dhe sëmundjeve tjera ngjitëse.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	

3	Veprimi 4.3 Duhet pasur vazhdimisht trajnime dhe përgatitje rreth plotësimin të njohurive rreth higjenës personale dhe kolektive të të ushqyerit , higjenës dhe ruajtjes së ushqimit	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
4	Veprimi 4.4 Trajtimi i shërbimit epidemiologjik për kontrollimin e ujit të pijshëm dhe marrjen e masave në parandalimin e ndotjes së ambientit për të gjithë qytetarët	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
5	Veprimi 4.5 Të mbahen fushata dhe trajnime nëpër shkolla përmes personelit shëndetësor për parandalimin e dukurive devijante -negative siç janë; prostitucioni, droga, alkooli, duhani dhe tjera.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
6	Veprimi 4.6 Çdoherë të bëhet monitorimi i fëmijëve që mos të punojnë punë të rënda dhe të rrezikshme për shëndetin siç janë; punë me hekurishta, pesticide etj.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	
7	Veprimi 4.7 Mbajtja e fushatave për ndërgjegjësimin dhe vetëdijen që të ulët numri i martesave në moshë re dhe të jetë në përputhje me ligjin mbi krijimin e martesës, familjes.	vazhdimisht	DSHMS- QKMF-ZKKK- OJQ-të	

Punësimi, mirëqenia sociale;

Qëllimi: Punësimi dhe përmirësimi i situatës ekonomike për të gjithë anëtarët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe tërë komuniteteve në tërësi konform përgaditjes për tregun e punës.

Objektivi1 :Rritje e nivelit të punësimit të individëve nga komuniteti jo shumicë , përmes ndërmjetësimit ,aftësimin profesional dhe punësimit në sektorin publik dhe privat

Aktiviteti 1:Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe eksistuese për aktivizimin e krahut të lirë të punës nga të tri komunitetet jo shumicë

	Periudha	Bartës	Buxheti
1 Veprimi 1.1 Punësimi i anëtarëve të tri komuniteteve në sektotrin publik sikur që është paraparë në Ligjin për shërbyesit civil	Vazhdimisht	MAPL Komuna ,ZKKK	BKK
2 Veprimi 1.2 Punësim ekskluziv për komunitete jo shumicë në fushën e ndërtimtarisë dhe të infrastrukturës, në përmirësim të kushteve të banimit në vendbanimet ku banojnë edhe pjestarët e komuniteteve jo shumicë	Vazhdimisht	Komuna DPUMH, ZKKK- MPMS	
3 Veprimi 1.3 Përfaqësim më i madh në sektorin publik në nivel lokal.	Vazhdimisht	Të gjitha institucione t publike	
4 Veprimi 1.4 Publikimi i raportit hulumtues	Vazhdimisht	D. për Admin- istratë, ZKKK	

Qëllimi 2 : Rritja e numrit të të punësuarve nga komunitetet jo shumicë në sektorin privat, ekonomik përmes hartimit dhe zbatimit të politikave aktive fiskale - ekonomike që nxisin punësimin dhe vetpunësimin. Hartimi dhe zbatimi i politikave për vetëpunësim të anëtarëve të tri komuniteteve përmes mbështetjes së ndërmarrjet të vogla dhe të mesme, privatizimit dhe iniciativave fiskale				
Aktiviteti :Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe ekzistuese për aktivizimin e krahut të lirë të punës nga të tri komunitetet jo shumicë		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Ndërmerren masa konkrete për zbutjen e taksave, tatimeve ndaj bizneseve të ndërrmarra nga tri komunitetet (p.sh. Lirimi nga taksta në dy vitet e para të biznesit etj.).	2023-2025	ZQK, ZQM, ZKM, NJDNJ, OJQ shoqatave e bizneseve, Oda Ekonomike Kosovës,Zyra e Tatim taksave NJDNJ , MPMS , MKK, BE ,ZKKK, DPZHE	BKK,
2	Veprim2.2 Mbahen takime të rregullta dhe nënshkruhen memorandume bashkëpunimi, mirëkuptimi mes Agjensisë Kosovare për Mbështetjen e Ndërrmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe institucioneve të kreditimit dhe mikrofinancave, për inkurajimin e biznesve nga anëtarët e tri komuniteteve dhe grupeve të tjera në tërësi.	Vazhdimisht	MEF, MAPL, MPMS, DBF, ZKKK donatore tjere,	BKK, donator tjerë
3	Veprimi 2.3 Krijohen programe specifike për qasje ndaj sektorit privat të cilat marrin parasysh veqoritë e tri komuniteteve	Vazhdimisht	MPMS, MEF, Komuna , ZKKK	
4	Veprimi 2.4 Realizohen trajnime me temën si të themelohet dhe zhvillohet afarizmi privat vetpunësimi i planifikuar nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale për zbatimin e Strategjisë për aftësimin e ndërmarrësit.	Vazhdimisht	MEF, MPMS, ZKKK, donator tjere	

5	Veprimi 2.5 Inkurajohen donatorët dhe institucionet e kredidhënies, të promovimit të biznesit dhe të mikro-financës të rriten në baza periodike fondet për biznese private dhe programe trajnuese për menaxhimin dhe këshillimin për anëtarët e tri komuniteteve	Vazhdimisht	MEF, MPMS, DBF,ZKKK, donator tjere	Donator tjerë
6	Veprim 2.6 Prodhimet e biznesit nga të tri komunitetet u krijojnë mundësitë e prezenimit të tyre në panairt e organizuara.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK, MPMS, OJQ- të	Donator tjerë
7	Veprimi 2.7 Krijojnë programe dhe mbështeten programe specifike për femrat e tri komuniteteve për veprimtaritë e bizneseve.	Vazhdimisht	MEF, MPMS, Komuna, DBF, DPZHE, ZKKK ,OJQ- te	Donator tjerë
8	Veprimi 2.8 Mbajtja e një studimi mbi ekonominë informale të tri komuniteteve dhe shqyrtimi i mundësive për kthimin e saj në ekonomi formale	Vazhdimisht	Komuna , DPZHE, DBF,ZKKK	BKK, donator tjerë

Objektivi 3: Inkurajim, përgatitje dhe mbështetje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për përfshirjen e tyre maksimale në aktivitete agrokulturore dhe grupeve të tjera të grave sidomos nënave vetushqyese që të meren me veprimtarit e tjera agrokulturore.				
Aktiviteti 3: Identifikimi dhe përzgjedhja e individëve nga tri të komunitetet të interesuar për të përfituar nga fondi I projekteve të MBPZHR, në fushën e mëposhtme, Bujqësi, Blegtori, Pemtari , Perime , Bletari etj.		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Mbatje e vizitave për informim mbi fondet e MBPZHR-së me komunitete Jo shumicë.	2023	Komuna ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	
2	Veprimi 3.2 Identifikimi I individëve ose grupeve të interesuara për të përfituar nga fondi i MBPZHR-së	Vazhdimisht	Komuna ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	
3	Veprimi 3.3 Stimulimi I individëve me të ardhura të ulëta, grave, familjeve me shumë anëtarë përmes vlerësimit të situatës ekonomike të të interesuarve për përfitime subvencioneve të ndryshme	Vazhdimisht	Komuna, DB F ,ZKKK, DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	Komuna , BKK, Donatorë tjerë
4	Veprimi 3.4 Ofrimi I ndihmës së duhur për përfitimin dhe përdorimin maksimal të fondeve nga ana e tri Komuniteteve (në veçanti ngritja e kapaciteteve të OJQ-ve nga këto tri komunitete me synim që ato vet të identifikojnë projektet, programet e mundshme përkatëse	Vazhdimisht	Komuna, DB F ,ZKKK DBPZHR, MBPZHR, OJQ -të	Komuna , BKK, Donatorë tjerë

Objektivi 4: Inkurajimim, përgatitje dhe mbështetje për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian për përfshirjen e tyre maksimale në aktivitete agrokulturore.				
Aktiviteti 4: Punësimi i përhershëm dhe i përkohshëm i komuniteteve RAE përmes projekteve sezonale dhe punësimit në sistemin publik.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Përfshirja e krahut të punës nga komunitetet në përpjekje sezonale pastrim të ambientit, punë bujqësore, pyllëzim të pyjeve etj.	2023	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, MPMS, MBPZHR, donatorë tjerë
2	Veprimi 4.2 Mbajtja e sesioneve- trajnimeve për aftësim dhe orientim sipas projektit dhe vendit të punës-për aftësim profesional në lami të caktuara me orientim sipas prioritetit të vendit te punës.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë
3	Veprimi 4.3 Organizimi i fushatave të vetdijësimit dhe informimit për shërbimet që ofron MBPZHR, dhe MPMS.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	
4	Veprimi 4.4 Mbledhja e të dhënave mbi numrin aktual të të regjistruarve nga tri komuniteteve pran zyrave të punësimit.	Vazhdimisht	ZKKK, ZP	
5	Veprimi 4.5 Vetdijësimi i komuniteteve rreth shërbimeve të qendrave për aftësim profesional (QAP) përmes takimeve dhe seminareve orientuese.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë

6	Veprim 4.6 Vendosja e kriterëve të trajnimit dhe respektimi i tyre, gjinia, mosha, ekzistenca në asistencë sociale etj.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK dhe donatorë tjerë
7	Veprim 4.7 Vlerësim i aftësive ekzistuese dhe organizmi i trajnimeve për aftësim profesional në përputhje me mundësitë e punësimit.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	BKK, donatorë tjerë
8	Veprimi 4.8 Përfshirje e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe komuniteti tjetër shumicë në projektet dhe skemat e punësimit të ndërmarrura nga donatorët (UNDP, USAID) etj.	Vazhdimisht	MPMS, MBPZHR, Komuna , ZKKK, OJQ, ZP , DPP, DAP	Donatorë

Objektivi 5 : Mundësimi i marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacionit, përfshirjes në skemat e ndihmës dhe ofrimit të shërbimeve në formë të barbartë dhe në përputhje me nevojat				
Aktiviteti :5 .Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ndërgjegjësimit , informimit dhe përfshirjes në skemat ekzistuese duke marrë parasysh edhe masat afirmative për këto komunitete		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Informimi i komuniteteve për mundësit e marrjes dhe llojet e shërbimeve sociale	2023 vazhdimisht	Komuna , MPMS, ZKKK, OJQ - të	BKK
2	Veprim 5.2 Ofrimi i ndihmave sociale për komunitete jo shumicë	Vazhdimisht	Komuna , MPMS, DSHMS, ZKKK	BKK
3	Veprimi 5.3 Ofrimi i ndihmave emergjente, shlyerja e borxheve të energjisë	Vazhdimisht	MPMS, MEF, Komuna ,KEDS ZKKK	
4	Veprimi 5.4 Informimi i komuniteteve përmes bisedave , takime me komunitet jo shumicë mbi të drejtat themelore në fushën e mirëqenies sociale	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK,OJQ	
5	Veprimi 5.5. Të drejtat e personave me nevoja të veçanta, masat për mbrojtjen e familjes dhe masat mbrojtëse në kodin civil	2023 vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ - të, Gjykatat	BKK, donatë tjerë

6	Veprim 5.6. Marrëdhëniet familjare në mes anëtarëve dhe zgjedhja e krizave në familje	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	
7	Veprimi 5.7.Përdorimi i mjeteve abuzive në familje, menaxhimi i rasteve dhe marrja e ndihmës nga punëtorët social	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK, donator tjerë
8	Veprimi 5.8.Mbrojtja nga trafikimi dhe abuzimi seksual i femrave dhe fëmijëve	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK dhe donator
9	Veprimi 5.9.Bashkëpunimi me OJQ-të dhe strehimoret për rehabilitimin e grave dhe fëmijëve që përjetojnë dhunë	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS, NDNJ ZBGJ, ZKKK, OJQ- të, Gjykatat	BKK, donatë tjerë
10	Veprimi 5.10 Lehtësimi në obligimet komunale për familjet që nuk kanë ndihmë sociale dhe asnjë formë tjetër të të ardhurave	Vazhdimisht	Komuna MPMS, DSHMS, , ZKKK,	BKK
11	Të parashihen të gjitha donacionet dhe subvencionet që të shkohen në vendet e merituar, të kontrollohen, të menaxhohen dhe të deklarohen prej organeve kompetente, lokale, qeveritare, përfaqësuese të komuniteteve, OJQ-ve , kohë pas kohe.	Vazhdimisht	Komuna, MPMS, MMPH , ZKKK	

Banimi, infrastruktura;

Qëllimi: Krijimi i kushteve për strehim për familje të komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian si dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve informale.

Objektivi: 1 Ndërtimi i shtëpive për familjet pa strehim dhe rastet sociale dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve joformale

Aktivitetit 1: Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim dhe adresimi i problemeve të këtyre familjeve		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim përmes vizitave në zonat ku banojnë komunitetet jo shumicë.	Vazhdimisht	ZKKK- DSHMS	
2	Veprimi 1.2 Adresimi i problemit të strehimit të këtyre familjeve në instanca tjera komunale e qeveritare dhe identifikimi i donatorëve potencial	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, MPMS, MKK, MAPL	BKK, donatorë tjerë

Objektivi 2: Lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve informale

Aktivitetit 2: Identifikimi i saktë i vendbanimeve jo-formale në zonat ku jetojnë këto komunitete.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Identifikimi i vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	ZKKK	
2	Veprimi 2.2 Lehtësimi i procesit të legalizimit përmes lehtësimit të kriterëve për legalizim dhe asistencë në përgatitjen e dokumentacionit.	Vazhdimisht	ZKKK, D.Admini- stratë	
3	Veprimi 2.3 Koordinimi i aktiviteteve në fushën e vendbanimeve , informatat me institucione të ndryshme qeveritare , vendore e ndërkombëtare.	Vazhdimisht	ZKKK	
4	Veprimi 2.4 Formimi i grupit punues për lehtësimin e kriterëve për procesin e legalizimit.	Vazhdimisht	ZKKK	
5	Veprimi 2.5 Hartimi dhe publikimi i raporteve 6 mujore të progresit të arritur në këtë fushë	Vazhdimisht	ZKKK	

Objektivi 3: Strehimi i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në kushte të rënda dhe të papërshtatshme të banimit që të bëhet përmirësimi i kushteve dhe				
Aktiviteti 3: Zgjedhje e qëndrueshme e banimit për familjet që jetojnë në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Përgatitja e projekt-propozimit për ndërtimin e shtëpive të atyre familjeve me gjendje të rëndë ekonomik-sociale	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, MPMS, MKK, OJQ-të	BKK , Komuna, donatorë tjerë
2	Veprimi 3.2 Përgatitja e databazës me të dhëna të detajuara për familjet.	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, OJQ-të	
3	Veprimi 3.3. Përzgjedhja dhe vendosja e familjeve sipas udhëzimit dhe programit për banim social	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS	BKK Komuna , donatorë
4	Veprimi 3.4 Të identifikohen familjet me shumë anëtarë, familje me një prind, dhe ato me individë me nevoja të veçanta që të përfitojnë më lehtë përmes propozimit nga komisioni të kenë çasje në urbanizëm dhe planifikim pjesëtarët me nevoja të veçanta që objektet publike dhe ato shëndetësore të jenë të çasshme për ta me pjerrina adekuate, trotualet parqet dhe sheshet të jenë të çasshme si dhe të kenë vend parking adekuat për ta në afërsi të objekteve publike.	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS	

Objekti 4: Strehimi i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në kushte të rënda dhe të papërshtatshme për banim që të bëhen projekte për përmirësimin e kushteve për banim dhe strehim				
Aktiviteti 4. Përmirësimi i kushteve të strehimit, qasje dhe përfshirje të komuniteteve jo shumicë në programet e strehimit-vendbanimit.		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 4.1 Ndërmerren aktivitete për identifikimin e familjeve jo shumicë që banojnë në kushte të rënda banimi	Vazhdimisht	ZKKK, DSHMS, OJQ-të	
2	Veprimi 4.2 Hartimi i projektit për përmirësimin e kushteve të banimit mbi bazën e rekomandimeve të dalta nga studimi, rregullimi i infrastrukturës rrugore, trotuareve, ndriqimeve, rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i kanalizimit, rrjeti i energjisë elektrike, i shërbimeve publike etj. Për të gjitha këto të bëhen kërkesat dhe hartimi i projekteve përmes përfaqësuesve të komuniteteve jo shumicë në drejtoritë përkatëse komunale përfshirë edhe OJQ Handikos.	Vazhdimisht	ZKKK, DPZHE, DSHMS, DSHPMSH , DPUMH	Donator
3	Veprimi 4.3 Përfshirja e komuniteteve përmes përfaqësuesve të tyre politik, OJQ-ve dhe dialogut të drejtëpërdrejtë me komunitetin në hartimin e planeve për strehim të ndërmarra nga niveli qendror dhe lokal.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK , OJQ, DSHMS, DSHPMSH MAPL, MKK , MPMS	Donatorë tjerë

Objektivi 5: Rregullimi i vendbanimeve joformale nga Qeveria e Kosovës, Komuna të ofron zgjedhje të qëndrueshme dhe trajtim të barabartë për komunitetet jo shumicë.

Aktiviteti 5. Hartimi dhe zbatimi i planeve për rregullimin e vendbanimeve informalën ekzistuese				
		Periodha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për identifikimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	ZKKK, DPKGJ MMPH	BKK
2	Veprimi 5.2 Hartimi i strategjisë dhe planit të veprimit për rregullimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	MMPH	
3	Veprim 5.3. Zbatimi i planit për identifikimin e vendbanimeve joformale	Vazhdimisht	MMPH , Komuna	BKK
4	Veprimi 5.4. Përmirësimi i ambientit për zhvillim të qëndrueshëm lokal	Vazhdimisht	DPZHE ZKKK	BKK, Komuna
5	Veprimi 5.5 Zhvillimi i resurseve njerëzore dhe rritja e punësimit	Vazhdimisht	MPMS, ZP, ZKKK	BKK
6	Veprim 5.6 Përmirësimi i infrastrukturës, mjedisi dhe shërbime publike	Vazhdimisht	Komuna	BKK

Objektivi 6: Strehimi dhe vendbanimi joformal				
Aktiviteti 6. Të bëhet zgjedhja e qëndrueshme për legalizim të vendbanimeve informale në ato vende që jetojnë komunitetet jo shumicë				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 6.1 Duhet të krijohen lehtësira në procesin e legalizimit të vendbanimeve informale nga komuna për rregullimin e dokumentacionit të pronave në ato raste kur prona nuk është në emër të tyre.	Vazhdimisht	Komuna, D. Administratë, DPKGJ, ZKKK	
2	Veprimi 6.2 Të shikohet edhe mundësia për dhënien e ndonjë prone publike për ato familje të komuniteteve jo shumicë që nuk kanë pronë dhe jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shumë nevojë për strehim.	Vazhdimisht	Komuna, MPMS, MMPH, ZKKK	

Mediat, kultura, rinia, sporti;

Objektivi: 1 Krijimi i mundësive për qasje të qytetarëve nga radhët e komuniteteve në radiot lokale dhe televizionet publike.				
Aktiviteti 1:Krijimi i mundësive financiare për zhvillimin e programeve radio dhe televizive që i dedikohen problematikave me të cilat përballen komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptian .				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 1.1 Vazhdimisht të bëhet informimi i komuniteteve që të marrin pjesë në të gjitha debatet publike me qytetarë, ku mund të debatojnë dhe t'i shpalosin kërkesat e tyre.	Vazhdimisht	Komuna, ZKKK, Drejtoria e Administratës etj	
2	Veprimi 1.2 Komunikimi me radio lokale për realizmin e një emisioni për të rinjtë që i dedikohen të rinjëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.	2023 vazhdimisht	MKRS,ZKKK K,DKRS, OJQ	

3	Veprimi 1.3 Shpërndarja e informacioneve të rëndësishme, veçanërisht për takimet publike dhe debatet të planifikimit buxhetor dhe vendosjes së prioriteteve për investime kapitale në vendbanimet ku më së shumti frekuentojnë banorët e këtyre komuniteteve si. Psh. Qendra-Podujevë, lagja "Ali Ajeti" , lagja "Xhafer Meta", fshatrat Orllan, Batllavë, Sfeçël, Peran	Vazhdimisht	Komuna , ZKXXX, DBF, DPUMH, DPZHE	
4	Veprimi 1.4. Promovimi i Ligjit për qasje në dokumente zyrtare në zonat ku banojnë komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të njoftimit për të drejtat e qasjes në informacionin dhe dokumentacionin zyrtar	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , ZKXX, D. Administratë	
5	Veprimi 1.5 Të shikohet mundësia e themelimit dhe përkrahjes së një qendre mediale të qëndrueshme për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian.	2023	MKRS, Komuna, ZKXX, OJQ-të	donatorë tjerë
6	Veprimi 1.6 Mbatja e kurseve për gazetari për pjestarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të ngritjes së tyre ideore e profesionale dhe të përfitimit në këtë fushë.	Vazhdimisht	ZKXX, OJQ-të ,	BKK, donatorë tjerë

Objekti: 2 Rritja e pjesëmarrjes rom, ashkali dhe egjiptian në procesin e vendim-marrjes për politikë, hartimi dhe zbatimi në fushën e kulturës dhe mediave në të gjitha nivelet				
Aktiviteti: 2 Rritja e kapaciteteve të anëtarëve të tri komuniteteve për mes aktiviteteve të edukimit formal dhe joformal				
		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 2.1 Ofrimi i mundësive për kryerjen e praktikave mësimore, studentëve jo shumicë pran institucioneve kulturore në baza të rregullta periodike. Subvencionet me bursa për të inkurajuar nxënësit nga komuniteti jo shumicë në vazhdimin e shkollimit të mesëm si dhe fakultet por edhe nxënësit dhe studentët me nevoja të veçanta.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, D. e Administratës, DKRS, ZKKK	BKK,
2	Veprimi 2.2 Ofrimi i trajnimeve për përfaqësues të komuniteteve dhe aftësimi i tyre në përdorimin e pajisjeve teknike, polika, editoriale, gazetari, menaxhim informacioni dhe komunikimi.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, ZKKK	
3	Veprimi 2.3 Mbështetje për aktivitete për ndërtim kapacitetesh për gazetari nga tri komunitetet.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, ZKKK	BKK, donatorë tjerë
4	Veprimi 2.4 Të nxiten mediat publike dhe ato private për krijimin e programeve të veçanta dhe rritjen e fizibilitetit dhe prezentimin e jetës së tri komuniteteve në programet lokale dhe televizive.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, ZKKK, QJQ	BKK, donatorë tjerë
5	Veprimi 2.5 Monitorimi i rregullt i mediave të shkruara dhe elektronike dhe ofrimi i raporteve analitike çdo fund viti mbi vendin që tri komunitetet zënë në hapësirat mediale.	Vazhdimisht	MKRS, DKRS, Drejtori e	BKK, donatorë tjerë

Objektivi: 3 Promovimi i identitetit kulturor të tri komuniteteve përmes mbrojtjes së trashigimisë kulturore dhe mbështetjes së aktiviteteve kulturore.				
Aktiviteti: 3 Ndërgjegjësimi i publikut mbi pasurinë kulturore të tri komuniteteve përmes aktiviteteve promovuese të kulturës së tri komuniteteve.		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 3.1 Aktivitetet kërkimore për identifikimin e objekteve kulturore nga të tri komunitetet	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	BKK, donatorë tjerë
2	Veprimi 3.2 Identifikimi i objekteve kulturore dhe shpallja e tyre si pasuri kombëtare.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
3	Veprimi 3.3 Publikimi dhe rritja e dijenisë publike mbi objektet e trashëgimisë kulturore.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
4	Veprimi 3.4 Mbështetja për mbledhjen faktografike për kulturën muzikën, artin e tri komuniteteve.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK-OJQ	
5	Veprimi 3.5 Identifikimi i artistëve nga tri komunitetet, dhe marrja e masave për kyqjen e tyre aktive në jetën kulturore si dhe personave me nevoja të veçanta.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK	
6	Veprimi 3.6 Organizimi i javës së kulturës rom, ashkali dhe egjiptian.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK,OJQ	BKK, donatorë tjerë

<p>Qëllimi: 4. Komunitetet rom, ashkali dhe egjpitase mund të zhvillojnë dhe promovojnë identitetin e tyre kulturor dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore dhe sportive.</p> <p style="text-align: right;">Objekti: 4</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës dhe mundësive financiare</p>			
<p>Aktiviteti: 4. Komuna të ofrojë hapsirë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive</p>			
1	Veprimi 4.1 Komuniteti jo shumicë ta kenë në dispozicion Qendrën Rinore për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK,
2	Veprimi 4.2 Përkrahja financiare të iniciativave kulturore dhe sportive që vijnë nga komunitete.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të BKK, donatorë tjerë
3	Veprimi 4.3 Përkrahje financiare për shënimin e dy festave kombëtare të komuniteteve RAE 15 shkurt-it dhe 8 Prill-it si dhe grupeve të tjera të përfshihen në datat e rëndësishme si persona me nevojë të veçanta, të drejtat e fëmijëve etj.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK, DBF BKK, donatorë tjerë
4	Veprimi 4.4 Komunitetet jo shumicë të inkurajohen në pjesëmarrje aktive në sporte në të gjitha klubet sportive që janë hapura për të gjithë të rinjtë që kanë talent në sporte që të jenë pjesë aktive e të gjitha klubeve sportive në komunën tonë, si p.sh: klubet, futboll, basketboll, volejbol, hentboll, karate, not. etj.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna, DKRS, ZKKK,
5	Veprimi 4.5 Të përkrahen dhe të ndihmohen të rinjtë e komuniteteve jo shumicë në komunën tonë që të jetë model për promovimin e vlerave multikulturore si në sport, kulturë, art, muzikë etj.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të
6	Veprimi 4.6 Në vazhdimësi të promovohet dhe mbrohet identiteti dhe pasuritë kulturore të komuniteteve jo shumicë në të gjitha fushët e kulturës.	Vazhdimisht	Komuna, DKRS, ZKKK, OJQ-të BKK, donatorë tjerë

<p>Qëllimi:5 Mbrojtja dhe promovimi i identitetit dhe pasurisë kulturore të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian</p> <p>Objektivi 5: Rritja e pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në procesin e vendim-marrjes për politikë- hartimin dhe zbatimin në fushën e medias, kulturës, rinisë, sportit në të gjitha nivelet.</p>				
<p>Aktiviteti: 4 Krijimi i një Komiteti të përbashkët për media, kulturë, rini dhe sport dhe mbikqyrja e projekteve për këto tri komunitete.</p>		Periudha	Bartës	Buxheti
1	Veprimi 5.1 Vendosja e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit me pjesëmarrjen e personaliteteve nga fusha e artit, kulturës, sportit nga tri komunitetet.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	
2	Veprimi 5.2 Anëtarët e komitetit vendosin mbi rregullat e funksionimit të tij dhe mbajnë takime të rregullta periodike mbi planifikimin dhe përcjelljen e aktiviteteve sipas planit të punës.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	
3	Veprimi 5.3 Komiteti ofron rekomandime mbi buxhetin për komunitete dhe prioritetet për këto aktivitete kulturore, si dhe raportimi i pasqyrave të shpenzimeve.	Vazhdimisht	MKRS, Komuna , DKRS, ZKKK, OJQ-të	

PS.

Hartimi dhe publikimi i këtij plani të veprimit është mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Europian OSBE

**Zyra Komonale për Komunitete dhe Kthim, Komuna e Podujevës,
Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazia Gjinore dhe
Komiteti Komunal Veprues.**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Raport i Diskutimit Publik Plan i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026

Plani i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026 është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Podujevës, Komuniteti Lokal Veprues si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe grupeve avokuese që merren me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, ku rolin kryesor e ka Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Ky Draft Plan i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026 synon të kontribuoj në zbatimin e legjislacionit në fuqi i cili siguron qasje të barabarta për të gjitha komunitetet si në arsim, punësim, shëndetësi, strehim, banim, infrastruktur, pa diskriminim duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha strukturat e qytetarëve e sidomos me grupet e cenushme në mënyrë që të ketë fushatë informuese për mënyrën e raportimit të rasteve të diskriminimit, racizmit, ngacmimit, gjuhës së urrejtjes dhe bullizmit.

Drafti Plan i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026 është përgatitur dhe proceduar në Kuvend më datë 31 tetor 2023, diskutimi publik ka zgjatë 30 ditë përkatësisht prej datës 06 nëntor 2023, deri më datë 06 dhjetor 2023, brenda kësaj periudhe kohore propozimet, sugjerimet, vërejtjet, kanë pasë mundësinë që të paraqiten sa ka zgjatë koha e diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; info.podujeva@rks-gov.net

Debati i përgjithshëm publik me qytetarë është caktuar të mbahet më 15 nëntor 2023 duke filluar nga ora 11:00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve, mirëpo vlen të theksohe edhe pse janë bërë njoftimet dhe lajmërimet për t'i paraqitur propozimet, vërejtjet apo sqarimet edhe gjatë diskutimit publik nuk ka pasur ndonjë vërejtje sugjerim apo propozim të adresuar qoftë në formë fizike dhe elektronike.

Bashkëngjitur gjeni këto dokumente;

Procesverbali nga takimi i grupit punues i datës 09.11.2023

Procesverbali nga diskutimi publik me qytetar i datës 15.11.2023

Nr.prot. 01-016/01-001221/24
Podujevë, datë 04.01.2024

Raportin e Përgatiti
SHZKKK Liman Zeqiri





Njësiti Për të Drejtat e Njeriut

Procesverbal i mbajtur më 09 Nëntor 2023, Diskutimi Publik – Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026

Mbledhja filloi në orën 14:05, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Liman Zeqiri**.

Në mbledhje të pranishëm ishin, dhe atë:

z.Ahmet Ahmeti, Makfire Zeka, Naim Potoku, Liridona Rrahmani, Xhafer Ademi, Genc Gashi, Ejup Babatinca, Arianit Shaqiri, Arbresha Bashota, Filloreta Çitaku, Naime Podvorica, Salih Hoxha, Adem Ajvazi, Blerim Vilasa, Selman Gashi, Halit Vershevc.

Rendi i Ditës: Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026

Z.Liman Zeqiri, theksoi, ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë diskutim publik apo takim pune lidhur me draft planin lokal të veprimit për barazi dhe mos diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026. Draft plani lokal i veprimit për barazi dhe mos diskriminim në Komunën e Podujevës, ka qenë në Kuvend Komunal dhe aty është diskutuar nga anëtarët e kuvendit komunal lidhur me çështjen e termit të diskriminimit apo mos diskriminim. Gjatë hartimit të këtij Draft Plani duhet të jemi të kujdesshëm me qëllim që të mos ketë fare diskriminim në të gjitha fushat e jetës. Çështja e diskriminimit është çështje që ka rëndësi të madhe, sepse përveç që është diskutuar në nivele të Komunave, është diskutuar si term edhe në konventat ndërkombëtare.

Me datën 15 e kemi diskutimin publik ku të gjithë kanë e kanë mundësin për ti dhënë komentet dhe vërejtjet lidhur me draft planin lokal të veprimit për barazi dhe mos diskriminim në Komunën e Podujevës.

z.Ahmet Ahmeti, theksoi, koordinator i njësimit për të drejtat e njeriut, theksoi, pra ky dokument apo draft plan është përgatitur më shumë nga z.Liman Zeqiri i cili ka dhënë kontribute për hartimin e këtij dokumenti. Si u njolluat nga z.Liman Zeqiri, ky dokument ka qenë në Kuvend Komunal dhe aty është diskutuar termi mos diskriminim apo diskriminim. Për hartimin e këtij plani z.Liman Zeqiri është bazuar në planin e integritimit. Ku në këtë draft plan kemi të bëjmë me integrim të përgjithshëm të personave dhe avancim të grave. Në këtë dokument është pastruar fenomeni RAE dhe më aty nuk ekziston. Sa i përket personave me aftësi të kufizuar duhet të kenë qasje sa më të lehtë në infrastrukturën e tyre, të përfshihet gjuha e shenjave pra duhet të bëhet një infrastrukturë e përgjithshme për personat me aftësi të kufizuar. Ndërsa sa i përket komunitet pakicë duhet të jetë interesimi më i madhe për arsim të mesëm.

znj.Makfire Zeka, theksoi, dëshirojë të di se a e ka lexuar ndonjë prej anëtarëve të kuvendit draft planin, apo vetëm kanë bërë vërejtje pa e lexuar fare.

z.Ahmet Ahmeti, po më e sa e kuptova unë është anëtarja e kuvendit znj.Donjeta Sheqiri e cila e ka lexuar këtë draft plan.

z.Xhafer Ademi, theksoi, Dokumentin nuk e kemi, mirëpo ju dëgjova që treguat që ka qenë vetëm një gabim në shkurtesën RAE dhe është larguar, ju faleminderit.

znj.Liridona Rrahmani, theksoi, e kam një pyetje lidhur me draft planin, se a keni të drejtë ju si hartues të këtij draft plani ti jeni të pranishëm në kuvend komunal që të prezantoni këtë plan në mënyrë që mos ketë dilema lidhur me këtë term që është diskutuar.

z.Liman Zeqiri, nga MAPL na është dërguar, strategjia dhe plani i veprimit për barazi dhe mos diskriminim, dhe në këtë formë ka dal edhe në Kuvend Komunal.

z.Ahmet Ahmeti, theksoi, ne jemi vetëm si grup punues, nga praktikat e kaluara nuk ka pasur rast që zyrtarët të prezantojnë në kuvend komunal draft planin apo ndonjë dokument tjetër, mirëpo këtë mund të bëjnë drejtorët e asaj drejtorie që ka hartuar atë dokument.

z.Selman Gashi, theksoi, kur është diskutimi publik e kemi mundësinë me bërë ndryshime sa i përket këtij draft plani, por jo të kalojnë afatet e mandej të jepen vërejtje.

z.Ejup Babatinca, theksoi, për hartimin sa më të mirë të këtij draft plani lokal të veprimit për barazi dhe mos diskriminim, ju rekomandoj që të konsultoni me një dokument i cili titullohet objektivat e qëndrueshme.


z.Naim Potoku, theksoi, rekomandimi im është që të keni një konsultim me drejtoreshën përkatëse para se të dal në Kuvend Komunal.

z.Adem Ajvazi, theksoi, me datën 15 e kemi diskutimin publik dhe besojë që të gjithë kanë mundësi që ti japin vërejtjet dhe komentet e veta.

z.Liman Zeqiri, meqenëse nuk ka tjerë të interesuar për të marr fjalën, atëherë e përfundojmë këtë mbledhje pune.

Mbledhja përfundoi në ora 14:40

Procesverbalin e mbajti


Arbrim Idrizi 

Nr.Prot. _____

Podujevë,

09 Nëntor 2023

Kryesuesi i takimi

Liman Zeqiri 

DISKUTIM:

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim në bashkëpunim dhe kordinim me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim:

-Organizojnë diskutime, konsultime për Draft- Planin lokal të Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026.

LISTA E PJESËMARRËSVE

NR	EMRI DHE MBIEMRI	INSTITUCIONI	NËNSHKRIMI
1	Dhimitër Ahmeti	NDM	Mirza
2	Martirë Zejra	D.S.H.M.S.	Mirza
3	Naim Potoku	A.P.S	Mirza
4	LIRIDONA RPAHMANI	ZY. INFORMIMIT	Mirza
5	Xhafer Adem	Kryeshtet Kom. për Kamur	Mirza
6	Genc Gashi	DPZHE	Mirza
7	Gjergj Babatjara	ELV "LLAPI"	Mirza
8	Antonit Shogun	D.A G.J.C	Mirza
9	Agnesa Keshota	DSHMS	Mirza
10	Filloreta Cizaku	Zhvillim Ekonomik	Mirza
11	Naime Redonovic	ZBAG	Mirza
12	Sajmir Haxhiu	ZJETAPO për D. Përm.	Mirza
13	AJEM AJVAZI	JKA	Mirza
14	Blerim Vilasa	DHA	Mirza
15	Selman Gashi	DKA	Mirza
16	Hodet Vajshorci	DSHMS	Mirza
17	Liman Zevci	SHZKKK	Mirza
18	Ylber Sahihu	ZKIE	Mirza
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			

35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			

Podujevë
09.11.2023



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040; nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPI) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPI) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores (MAPI) nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, dhe nenet 14, 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.prono-1-020-01-005086218, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2023 mori vendim:

VENDIMI PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik:

- **Drafti Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026**

Neni 2

Diskutimi publik sipas këtij paragrafi, zgjat 30 ditë përkatësisht prej datës, **06.11.2023 deri më 06.12.2023**, brenda së cilës Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim në bashkëpunim dhe koordinim me Njësinë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim mund të organizojnë diskutime/konsultime të ndryshme publike, kurse Debatit i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më **15.12.2023** duke filluar nga ora **11:00**, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve **15.11.2023**

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë debateve publike, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit/konsultimit publik në Zyrën për Komunikim me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike në e-mail adresën; **info.podujeva@rks-gov.net**; të cilat pastaj përcjellën në Njësinë, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: **<http://kk.rks-gov.net/podujeve>** (rubrika; aktet për diskutim publik), në Platformën qendrore të konsultimeve publike, si dhe në lokalitete të ndryshme aty ku Komuna e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi/debatit publik zbatohet nga Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim e cila bashkëpunon dhe koordinon me Njësinë për të Drejtat e Njeriut, dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, që përkujdesen për përgatitjen dhe publikimin e raportit nga konsultimi dhe debati publik dhe të jepen sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Pas shqyrtimit dhe miratimit, Vendimi hyn në fuqi pas 7 ditë pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.Prot. 01-016/01-0079525/23
Podujevë, datë: 31.10.2023





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



Njësitë Për të Drejtat e Njeriut – Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Procesverbal i mbajtur më 15 nëntor 2023, Diskutimi Publik – Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës.

Mbledhja filloi në orën 11:10, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Liman Zeqiri shef i ZKK-së. Në mbledhje të pranishëm ishin, zyrtarë komunal bashkëngjitur gjeni listën e nënshkrimeve.

Rendi i Ditës: Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKK-së, theksoi, ky dokument është vënë në diskutim publik prandaj ne sot jemi mbledh këtu për të diskutuar rreth këtij draft plani andaj nga ana e juaj pres që t'i paraqitni të gjitha vërejtjet, sugjerimet, komentet në mënyrë që ta pasurojmë sa më shumë këtë dokument, nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar urdhëroni, nëse jo ju njoftoj se sugjerimet komentet apo vërejtjet e juaja mund t'i paraqitni edhe në formë elektronike deri më datë 06.12.2023. Në këtë dokument është punuar mjaftë, janë bërë spastrime të tekstit prandaj edhe njëherë ju them që pa hezitar t'i paraqitni propozimet e juaja para se ta merr formën përfundimtare ky dokument.

z.Ahmet Ahmeti, koordinator i njësitit për të drejtat e njeriut, theksoi, në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës ne sot jemi mbledhur në këtë takim për diskutim publik për Planin Lokal të Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës, ky dokument i ka kaluar fazat e diskutimi sepse edhe në takimin e më parshëm është diskutuar rreth objektivave të këtij dokumenti, gjegjësisht rreth formulimeve sepse kanë qenë disa keqkuptime në Kuvend, me aprovimin e juaj ne ju kemi qas këtij dokumenti dhe në çdo shtyllë kemi bërë ndërhyrje në këtë draft në mënyrë që të kemi një material sa më të zgjeruar që i dedikohet komuniteteve jo shumicë në Komunën tonë në mënyrë që ata mos të ndihen të diskriminuar në të gjitha fushat e jetës qoftë në arsim, shëndetësi. Një kujdes më të theksuar e kemi pas edhe për personat me nevoja të veçanta, sidomos për nxënësit të cilët kanë hasur në vështirësi ku kemi identifikuar gjitha pengesat në shkollat ku ata vijojnë mësimet dhe jo vetëm këtë por ne kemi evidentuar edhe problemet tjera si në rrugë, trotuare shkolla me të vetmin qëllim që këta fëmijë të kenë qasje më të lehtë në ambientet shkollore.

z.Adem Ajvazi, zyrtar DKA, theksoi, nga ajo që u cek nga parafolësi im sa i përket infrastrukturës shkollore për fëmijët me nevoja të veçanta mendoj se është bërë një punë e mrekullueshme por vlen të theksohet se shkolla në fshatin Kërpimeh ka vend ende për përmirësime në infrastrukturë, prandaj duhet të bëhen investime nga ana e komunës për rregullimin e trotuareve dhe vendkalimeve për fëmijët me nevoja të veçanta.

z.Xhafer Ademi, kryesues i komitetit për komunitete, theksoi, në Komunën e Podujevës nuk ka segregacion sa i përket çështjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, eliminimin i fjalën RAE ka qenë me vend sepse ai emërtim në draft ka qenë i pa nevojshëm. Sa i përket shëndetësisë në Komunën e Podujevës e them se është në nivel ashtu është edhe përfshirja e nxënësve në procesin mësimor, prandaj ju përgëzoj për këtë dokument duke shpresuar se në të ardhmen do të realizohet.

z.Ahmet Ahmeti, koordinator i njësimit për të drejtat e njeriut, theksoi, ne kemi paraparë edhe bursa për nxënësit e komuniteteve jo shumicë në komunën e Podujevës, si për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në mënyrë që këta nxënës mos t'i braktisin bankat shkollore prandaj te planifikimi i buxhetit do të ndahet një shumë për këtë kategori.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKK-së, theksoi, ky dokument është vënë në diskutim publik prandaj nga ana e juaj presim sugjerimet, komentet, vërejtjet këto mund t'i paraqisni në formë elektronike deri më datë 06.12.2023, nëse ka dikush për të shtuar, apo ndryshuar diçka urdhëroni, nëse jo atëherë e mbyll këtë takim.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesverbalin e mbajti
Osman Bajrami



Nr.Prot.01-060/04-0082408/23
Podujevë,
15 nëntor 2023

Kryesuesi i takimit
Liman Zeqiri



DEBAT PUBLIK:

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Informim në bashkëpunim dhe kordinim me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim organizojnë:

-Debat i përgjithshëm publik me qytetarë i cili mbahet më 15.11.2023 duke filluar në ora 11:00 në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhësë – salla e mbledhjeve.

-Tema: Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe Mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026.

LISTA E PJESËMARRËSVE

NR	EMRI DHE MBIEMRI	INSTITUCIONI	NËNSHKRIMI
1	Osman Bajrami	Zyrt. KK Podujevë	
2	ADEM AJVATZ	JKA	
3	Ejup Baberhaci	K. Podujevës	
4	Armi Nikollari	Zyrt. në DKA	
5	Genç Gashi	Zyrt. e	
6	Ylber Salihu	Zyrt. e	
7	Filloreta Cikalci	K. Podujevës	
8	Mirvete Herovci	K. Podujevës	
9	Xhaver Ademi	Kryt. komit. pop. komit.	
10	Selver Besro	H. i Komun. t. l.	
11	Arbata Basha	L. POUJAVE	
12	Najfe Gerguri	K. POUJAVE	
13	Must. Gashi	NDKJ	
14	Limari Zekiri	SHZKKK (Podujevë)	
15	SAHIT HASANI	Z. D. FESTIVAL	
16	ARMIR MULLIC	Z. PËN SHKËMBIM	
17	MUSTIFER ZHITIA	COORDINATOR PËR GJYK.	
18	FAIK GASHI	Zyrt. e DKA	
19	Naxhije Hasani	Zyrt. e Shëndetit	
20	Ramush Jupolli	Asistent Administrativ	
21	YMER HOTI	DBPZHR	
22	Majlinda Gashi	DBPZHR	
23	ISMET JADRI	URBAHIZEN	
24	Fidlon Restelica	DPUMM	
25	PAJTIME SADIKU	DI	
26	Fozhuan Komari	Zyrt. Inspektorat	
27	Emine Tahiri	ARBK	
28	Shkurd Musa Fazliu	ARBK	
29	Ulirmore Restelica	DPZHC	

30	VALMIRA POLLOMIJ	Komuna e Podujevës	Polimij
31	Vehedin Avdiullahu	Helmen e Podujinës	Helmen
32	Alfonz Hoxha	Janina e Podujit	Alfonz
33	Haxhiqiri	Komuna e Podujit	Haxhiqiri
34	Shyrra Marku	K. Podujit	Shyrra
35	Naime Gjonmali	ZMP/1	Naime
36	Gent Metullahu	ZMP/1	Gent
37	Blerta Ajvazi	ZMP/1	Blerta
38	LIRIDONA RRAHMANI	ZMP/1	Liridona
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			

Podujevë
15.11.2023

W



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d); 17 shkronja m dhe 40.2 shkronja e) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 64 paragrafi 2.4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM PËR LIRIM NGA PAGESA

Neni 1

Miratohet vendimi për lirim nga pagesa për pjesëtarët e Policisë dhe Zjarrfikësve të Kosovës për shërbimet që ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare dhe institucionet tjera shëndetësore në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot.01-401/03-0012202/24
Podujevë, datë: 20.02.2024

Drejtoresha
Adelinë Stublla



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1.1 të Rregullores MAPL nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës, ndërlidhur me nenet 62.3, 11; 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja e) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, nenit 64 paragrafi 2.4, neneve 14; 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 34 paragrafi 2.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendit të Komunës së Podujevës, i,

Propozohet

VENDIM

PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE KOMISIONIT TË BANUESHMËRISË

Neni 1

Me këtë vendim caktohet komisioni për verifikim të banueshmërisë në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, dhe atë nga një anëtar/e prej të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend dhe një anëtar/e nga shoqatat e dala nga lufta, në këtë përbërje;

_____ anëtar/e nga LDK
_____ anëtar/e nga LVV
_____ anëtar/e nga PDK
_____ anëtar/e nga AAK
_____ anëtar/e nga OBDK
_____ anëtar/e nga Shoqatat e dala nga lufta

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.prot.01-40/03-0012202/24
Podujevë, datë: 20.02.2024

Drejtoresha
Adelinë Stublla



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS Kryesuesi i Kuvendit

R A P O R T I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2023

Kuvendi i Komunës së Podujevës duke u bazuar në Planin e Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023, procedimit dhe çështjeve të ndryshme nga Ekzekutivi i Komunës dhe varësisht nevojave të paraqitura si dhe në bazë nenit 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, paraqitet Raporti në vijim:

Kuvendi i Komunës së Podujevës gjatë kësaj periudhe ka funksionuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, ligjeve tjera të veçanta varësisht fushave përkatëse, akteve të tjera nënligjore, Statutit të Komunës së Podujevës si dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Gjatë vitit 2023, Kuvendi i Komunës së Podujevës ka mbajtur gjithsej 15 mbledhje, prej tyre 8 të rregullta, 4 mbledhje të jashtëzakonshme, 3 mbledhje solemne, ndërsa që nga fillimi i këtij mandati e deri më tani janë mbajtur 34 mbledhje të Kuvendit duke përfshirë edhe mbledhjen konstituive/inauguruese, në përputhje të plotë me nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në të cilin ndër të tjera thuhet:

Neni 43

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës

43.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

43.2 Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, siç përcaktohet me Rregulloren e Punës.

43.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;*
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;*
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;*
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe*
- e) materialet e mbledhjes.*

f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

43.4 Njoftimi dhe materialet e mbledhjes duhet të respektojnë Ligjin mbi Gjuhët. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.

43.5 Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithashtu t'i dërgohet ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Kuvendi i Komunës duke marrë për bazë Planin e Punës për vitin 2023 ka shqyrtuar çështje/pikat e parapara por edhe çështje të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës si dhe çështje të përcaktuara nga Grupe të këshilltarëve të Kuvendit dhe anëtarë të Kuvendit të Komunës.

Në vijim paraqiten temat – çështjet e shqyrtuara në Kuvend, sipas mbledhjeve gjatë vitit 2023, (tenditja sipas datave të mbledhjeve të Kuvendit në vitin 2023)

Mbledhja e nëntëmbëdhjetë e mbajtur më 31.01.2023

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 31.10.2022 e vazhduar më 03 dhe 07.11.2022, si dhe nga mbledhja e datës 09.12.2022.
2. Propozim Rregullorë për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi.
3. Propozim Rregullorë për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës.
4. Propozim Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit.
5. Kërkesa – Nisma e procedurës për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunave: Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq
- Propozim vendim për miratimin e Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal
- Propozim vendim për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin përkatës të bashkëpunimit ndër-komunal
6. Propozim Vendim për shpalljen në interes publik - pronat që preken nga projekti për ndërtimin e rrugës lidhëse nga magjistratja Prishtinë-Podujevë deri te rruga “Vëllezërit Frashëri”
7. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës
8. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike - Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a
9. Propozim Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo – arsimore
10. Propozim Vendim - për destinimin e paluajtshmëris për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale
11. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Programi Trevjeçar i Banimit 2023- 2025
12. Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027
13. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Barazi Gjinore (pas dhënies së dorëheqjes së znj. Drita Pajaziti për shkak të emërimit anëtare në Komitetin për Politikë dhe Financa)
14. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022
15. Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023. (Deklaratë e miratuar drejtuar QRK - MF-së)
16. Të Ndryshme

Mbledhja e njëzetë e mbajtur më 14.02.2023 – e jashtëzakonshme

E thirrur në kërkesë të 12 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës

- Diskutim rreth vërshimeve në Komunën e Podujevës

Mbledhja e njëzetënjë e mbajtur më 17.02.2023 – Solemne

- Intonimi i Himnit

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit

➤ Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës

Mbledhja e njëzetedy e mbajtur më 06.03.2023 – Solemne

Për nderë të Shënimit të 25 vjetorit të “EPOPESË së UÇK-së” dhe ka për qëllim shënimin dhe promovimin e vlerave të luftës së UÇK-së dhe kontributin e Familjeve të Dëshmorëve për lirinë e Kosovës

Mbledhja e njëzetetë e mbajtur më 10.03.2023 – e jashtëzakonshme

E thirrur në kërkesë të kryetarit të komunës

1. Raporti përfundimtar i Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

2. Rishqyrtimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023 - 2025

Mbledhja e njëzetekatër e mbajtur më 07.04.2023

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më: 31 janar 2023; 14 shkurt 2023; 17 shkurt 2023; 06 mars 2023 dhe 10 mars 2023

2. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 - *Raporti nga diskutimet publike*

3. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të Draft Planit të Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027

4. Propozim Programi trevjeçar i banimit 2023-2025 – *Raporti nga diskutimi publik / Debat i Publik lidhur me programin tre vjeçar të banimit 2023-2025*

5. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022

6. Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi 2023

7. Kërkesë nga Qendra Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës

8. Propozimi që data 5 maj të caktohet ditë pushimi në Komunën e Podujevës (*pikë shitesë e cila pas debatit është shtyrë për një mbledhje të radhës*)

9. Propozimi për themelimin e Zyrës për Investime, në kuadër të Administratës Komunale (*pikë shitesë e cila pas debatit është shtyrë për një mbledhje të radhës*)

10. Të ndryshme

Mbledhja e njëzetepesë e mbajtur më 15.05.2023

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

2. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - Lokalet afariste në Tregun e Oytetit

3. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës-Lokalet afariste në Tregun e Oytetit

4. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për vitin 2022
6. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-mars 2023
7. Informatë e punës për vitin 2022 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Podujevës
8. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025
9. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 – 2026 në Komunën e Podujevës
10. Raport informues i ecurive të punës në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë
11. Raporti i punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janar-prill 2023
12. Shpallja e Doris Paek. Qytetare Nderi e Komunës së Podujevës *(Pikë shtesë rekomandim nga nga KPF)*
13. Të ndryshme

Mbledhja e njëzetegjashhtë e mbajtur më 19.06.2023 - Solemne

- Intonimi i Himnit

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesi i Kuvendit
 - Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës
3. Fjalë rasti e përfaqësuesit të Shoqatave të dalta nga Lulla e UÇK-së

Mbledhja e njëzeteshtatë e mbajtur më 29.06.2023, e vazhduar dhe përfunduar më 03.07.2023

1. Të ndryshme
2. Procesverbali nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më 07 prill 2023
3. Korniza Afatmesme Buxhetore e komunës së Podujevës për periudhën 2024 – 2026
4. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
5. Propozim vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga qiratë në Tregun e Qytetit të Podujevës
6. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit - Shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në Qytetin e Podujevës – *(Pikë shtesë brenda mbledhjes)*
7. Kërkesën e Kryetarit të Komunës, për Nismën e procedurës për bashkëpunim ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Komunën Grubisno Polje në Kroaci
 - *Propozim Vendimi për miratimin e nismës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar - Binjakëzim me Komunën Grubisno Polje në Kroaci.*
 - *Propozim Vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar-binjakëzim me Komunën Grubisno Polje në Kroaci - (Pikë shtesë brenda mbledhjes)*
8. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të FSK-së në KKS
9. Draft Plani i Integritetit 2023 – 2027 për Komunën e Podujevës.
10. Kërkesa e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për iniciimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së Komunës me qëllim të ndërtimit të rezervuarit sipas projektit “Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në fshatin Orllan”, të shqyrtohet në këtë mbledhje, dhe atë duke marrë për bazë natyrën urgjente të realizimit të projektit në fjalë. *(Pikë shtesë gjatë mbledhjes)*

Pikat si në vijim që kanë qenë në kuadër të rendit të ditës sipas renditjes përkatëse me thirrjen e mbledhjes, me kërkesë të Drejtoreshës së DPKGJ janë heq nga rendi i ditës për arsye të mos interesimit të sektorit joqeveritar lokal për të paraqitur anëtarët e tyre në komisionet vlerësuese.

5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. "Skënderbeu"

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

8. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi

Mbledhja e njëzetetë e mbajtur më 31.07.2023

1. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, për vitin 2022.

2. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Podujevës, për vitin fiskal 2022.

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periadhen Janar – qershor 2023.

4. Propozim Vendimi për transferim të buxhetit të komunës për vitin 2023.

5. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin-Furni me mekanizëm bujqësor

6. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin "Furnizim me sera".

7. Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës.

8. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollor 2022-2023.

9. Propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025. - Raporti nga konsultimi publik.

10. Propozim Planit i veprimtimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës. - Raporti nga konsultimi publik.

11. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. "Skënderbeu"

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

12. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

13. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

14. Propozim: Vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupaç i Poshtëm - *Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.*
15. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik të *Draft Statutit të QKMF-Podujevë.*
16. Të Ndryshme

Mbledhja e njëzetentë e mbajtur më 27.09.2023

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 15.05.2023; 19.06.2023; 29.06.2023 - *e vazhduar dhe përfunduar më 07.07.2023*
2. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026
3. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri-projekti furnizim me mekanizëm bujqësor
4. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme 2024
5. Propozimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - *Raporti nga konsultimi publik*
6. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027-Raporti i konsultimit publik
7. Informatë e DKA për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024
8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal.
9. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimt për mbrojtje nga dhuna në familje, 2023 i 2026.
10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës - Rishqyrtim. *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
11. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti Furnizim me mëshqerra *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
12. Raporti përfundimtar i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës. *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
13. Plotësimi i përbërjes së Komitetit për Komunitete me një anëtarë/c nga radhët e komunitetit ashkali - Fikmete Qurkollli në vend të Naile Ahmetit. *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
14. Të Ndryshme

Mbledhja e tridhjetë e mbajtur më 31.10.2023

1. Procesverbal nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 korrik 2023
2. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024
3. Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimt për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026
4. Marrja e vendimit për lirim nga pagesa e Mamografisë – *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
5. Propozim vendimi për themelimin e Komisionit të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Llapi” në Podujevë - *(Pikë shitesë rekomandim nga KPF)*
6. Të Ndryshme

Mbledhja e tridhjetenjë e mbajtur më 23.11.2023, e jashtëzakonshme

E thirrur në kërkesë të Kryetarit të Komunës, me këtë pikë të rendit të ditës:

- Propozim vendimi për shtypjen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Mbledhja e tridhjetedy e mbajtur më 08.12.2023, e jashtëzakonshme

E thirrur në kërkesë të Kryetarit të Komunës, me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Propozim vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023
2. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. "Llapi 1932" SH.P.K.

Mbledhja e tridhjetetë e mbajtur më 28.12.2023

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 27.09.2023; 31.10.2023; 23.11.2023; 08.12.2023.

2. Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

3. Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare - *ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022, (Pikë e cila është shtyrë për një prej mbledhjeve të radhës).*

4. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023

5. Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

6. Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal - *Raporti nga konsultimi publik*

7. Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndërkomunal Shumë-Funkcional - *e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komunat; Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq. (Pikë shtesë rekomandim nga KPF)*

8. Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Podujevës, sipas kërkesës së MMPHI. *(Pikë shtesë rekomandim nga KPF)*

9. Të Ndryshme

Nga mbledhjet e mbajtura në vitin 2023, aktet e miratuara, janë:

Vendimet:

NR	EMËRTIMI I AKTIT	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
1	Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike në vendbanimet rurale dhe orarin e qarkullimit	01-345/01-0008885/23	31.01.2023
2	Vendim për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal	01-016/01-0008886/23	31.01.2023
3	Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal	01-020/05-0008887/23	31.01.2023
4	Vendim për shpallje interes publik - <i>Pjesët e ngastrave kadastrale që preken nga Ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistralia Podujevë-Prishtinë deri në rrugën "Vëllezërit Frashëri".</i>	01-016/01-0008890/23	31.01.2023
5	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në qytetin e Podujevës	01-353/01-0008893/23	31.01.2023
6	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pasrimi" sh.a	01-400/03-0008895/23	31.01.2023
7	Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës - <i>për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, për një (1) vit shkollor.</i>	01-020/04-0008896/23	31.01.2023
8	Vendim-destinimi për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale në Qytetin e Podujevës, Paluajtshmëria e cila aktualisht shfrytëzohet për Treg të Gjëlber.	01-353/01-0008897/23	31.01.2023
9	Vendim për vënien në diskutim publik - Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2023-2025.	01-016/01-0008898/23	31.01.2023
10	Vendim për vënien në diskutim publik-Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027.	01-016/01-0008899/23	31.01.2023
11	Vendim - <i>ndryshohet dhe plotësohet përbërja e Komitetit për Barazi Gjinore Komunitete, sipas Vendimit nr.prot.01-020/04-0053366/22 për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Barazi Gjinore.</i>	01-020/04-0008900/23	31.01.2023
12	DEKLARATË Drejtuar: <i>Qeverisë së Republikës së Kosovës / Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Lidhur me faljen e tatimit në pronë në shumë deri në 100€ për të gjithë tatimpaguesit e Komunës së Podujevës për vitin 2023.</i>	01-345/01-0008882/23	31.01.2023
13	Vendim për miratimin e raportit përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	01-401/04-0018820/23	10.03.2023
14	Vendim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025 (<i>Procedurë e rishqyrtimit</i>)	01-300/01-0018821/23	10.03.2023
15	Vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2023	01-016/01-0025737/23	07.04.2023
16	Vendim për vënie në konsultim publik - <i>draft Plani i Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027</i>	01-016/01-0025738/23	07.04.2023
17	Vendim për miratimin e Programit Trevjeçar të Banimit 2023 -2025	01-016/01-0025739/23	07.04.2023

18	Vendim për miratimin e planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023	01-016/01-0025740/23	07.04.2023
19	DEKLARATË për mbështetjen e kërkesës që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës	01-016/01-0025741/23	07.04.2023
20	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore	01-016/01-0033565/23	15.05.2023
21	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - Lokalet afariste në Tregun e Qytetit	01-016/01-0033569/23	15.05.2023
22	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të komunës- Lokalet afariste në Tregun e Qytetit	01-016/01-0033570/23	15.05.2023
23	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës	01-016/01-0033581/23	15.05.2023
24	Vendim për vënie në konsultim publik - draft Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 - 2025	01-016/01-0033583/23	15.05.2023
25	Vendim për vënie në konsultim publik - draft Plani i veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2023 - 2026 në Komunën e Podujevës	01-016/01-0033585/23	15.05.2023
26	Vendim për shpalljen qytetare nderi e Komunës së Podujevës znj.Doris Pakc ish Eurodeputete dhe anëtare shumëvjeçare e Bundestagut gjerman dhe Parlamentit Evropian, si dhe emërtimi i një rruge kryesore me emrin e saj.	01-016/01-0033587/23	15.05.2023
27	Vendim për miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 të Komunës së Podujevës.	01-400/03-0045350/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
28	Vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.	01-400/03-0045353/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
29	Vendim për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga qiratë në Tregun e Qytetit të Podujevës.	01-360/05-0045370/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
30	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit - Shtëpi për qëndrim ditë të personave të moshuar në qytetin e Podujevës. (MAPL kërkesë për rishqyrtim të aktit)	01-016/01-0045382/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
31	Vendim për miratimin e kërkesës – nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar-binjakëzimit me Komunën Grubisno Polje në Kroaci.	01-016/01-0045386/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
32	Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Komunën Grubisno Polje në Kroaci.	01-016/01-0045389/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023

33	Vendim për zëvendësimin e një anëtari të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	01-016/01-0045371/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
34	Vendim për miratimin e Planit të Integritetit 2023 – 2027 në Komunën e Podujevës.	01-016/01-0045377/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
35	Vendim për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.	01-016/01-0045395/23	03.07.2023 Vazhdim i mbledhjes së 29.06.2023
36	Vendim për transferimin e buxhetit të komunës për 2023	01-422/01-0055055/23	31.07.2023
37	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “furnizimi me mekanizëm bujqësor”	01-400/03-0055059/23	31.07.2023
38	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti “furnizimi me sera”	01-400/03-0055063/23	31.07.2023
39	Vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e komunës së Podujevës. (MFPT vlerësim jo në harmoni me ligjin dhe rekomandim që lidhur me këtë të drejtoheni në MPB))	01-422/01-0055082/23	31.07.2023
40	Vendim për miratimin e plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 - 2025	01-016/01-0055093/23	31.07.2023
41	Vendim për miratimin e plani i veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2023 – 2026 në Komunën e Podujevës	01-016/01-0055101/23	31.07.2023
42	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - Lokalet afariste në sipërfaqe 50 m ² dhe 55 m ² të ndërtuar në njësinë kadastrale P-71712062-00459-0, në ZK Podujevë	01-463/06-0055107/23	31.07.2023
43	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – Lokalet afariste në sipërfaqe 50 m ² dhe 55 m ² të ndërtuar në njësinë kadastrale P-71712062-00459-0, në ZK Podujevë.	01-463/06-0055262/23	31.07.2023
44	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – tokë bujqësore me sipërfaqe 23403 m ² , me numër kadastral P-71712029-00495-4 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055118/23	31.07.2023
45	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – tokë bujqësore me sipërfaqe 23403 m ² , me numër kadastrale P-71712029-00495-4 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055123/23	31.07.2023
46	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës – tokë bujqësore me sipërfaqe 44773 m ² , me numër kadastrale P-71712029-00202-1 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055130/23	31.07.2023

47	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - tokë bujqësore me sipërfaqe 44773 m ² , me numër kadastrale P-71712029-00202-1 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055126/23	31.07.2023
48	Vendim për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - tokë bujqësore me sipërfaqe 38882m ² , me numër kadastrale P-71712029-00209-0 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055135/23	31.07.2023
49	Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës - tokë bujqësore me sipërfaqe 38882m ² , me numër kadastrale P-71712029-00209-0 në ZK Lupç i Poshtëm.	01-463/06-0055137/23	31.07.2023
50	Vendim për vënien në konsultim publik - <i>draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF-Podujevë</i>	01-550/01-0055138/23	31.07.2023
51	Vendim për miratimin e projektbuxhetit të Komunës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025-2026	01-413/01-0071612/23	27.09.2023
52	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri – projekti për furnizim me mekanizëm bujqësor	01-320/01-0071615/23	27.09.2023
53	Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024	01-431/03-0071624/23	27.09.2023
54	Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare	01-110/04-0071627/23	27.09.2023
55	Vendim për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Podujevës 2023-2027 (MMPH kërkesë për rishqyrtim të aktit)	01-352/11-0071630/23	27.09.2023
56	Vendim për vënie në konsultim publik - <i>draft Plani Operativ Emergjent Lokal</i>	01-070/05-0071632/23	27.09.2023
57	Vendim për vënie në konsultim publik - <i>draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026</i>	01-016/01-0071626/23	27.09.2023
58	Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës – (Procedurë e rishqyrtimit)	01-945/02-0071611/23	27.09.2023
59	Vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri - projekti për furnizim me mëshqerra.	01-320/01-0071613/23	27.09.2023
60	Vendim për miratimin e Raporti përfundimtar të komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.	01-401/04-0071617/23	27.09.2023
61	Vendim - ndryshohet dhe plotësohet përbërja e komitetit për komunitete, znj.Fikmete Qurkollli, nga radhët e komunitetit jo shumicë emërohet anëtare i komitetit për komunitete, në vend të znj.Naile Ahmeti.	01-016/01-0071619/23	27.09.2023
62	Vendim për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	01-016/01-0079522/23	31.10.2023
63	Vendim për vënie në konsultim publik <i>Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazi dhe mos Diskriminim në Komunën e Podujevës 2023-2026</i>	01-016/01-0079525/23	31.10.2023
64	Vendim për lirimin nga pagesa e shërbimit shëndetësor Mamografi në QKMF Podujevë.	01-016/01-0079528/23	31.10.2023

65	Vendim për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale – “Eko-Llapi” sh.a.	01-016/01-0079532/23	31.10.2023
66	Vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm publik - disa prona të paluajtshme të cilat janë nën menaxhimin e AKP.	01-020/06-0083797/23	23.11.2023
67	Vendim për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023	01-400/02-0086532/23	08.12.2023
68	Vendim për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 20,000.00€, me destinim për subvencionimin e Klubit të Futbollit K.F. “Llapi 1932” SH.P.K. Podujevë.	01-400/03-0086533/23	08.12.2023
69	Vendim për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024	01-463/06-0090904/23	28.12.2023
70	Vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm – Zona Industriale	01-016/01-0090910/23	28.12.2023
71	Vendim për miratimin e Planit Operativ Emergjent Lokal	01-016/01-0090892/23	28.12.2023
72	Vendim për miratimin e Marrëveshjes Kornizë të Bashkëpunimit Ndër-komunal Shumë-Funksional – e lidhur mes 6 Komunave të Republikës së Kosovës, dhe atë: Kryeqyteti Prishtina; Komunit Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq.	01-016/01-0090903/23	28.12.2023
73	Vendim për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023/27 (Procedurë e rishqyrtimit)	01-016/01-0090908/23	28.12.2023
74	Vendim për ngritjen e Komisionit Ad-Hoc - Për shikimin, vlerësimin dhe analizimin e dokumenteve të fermerëve lidhur me kompensimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në vitin 2022	01-020/04-0000047/24	28.12.2023

Rregulloret:

NR	EMËRTIMI I AKTIT	NR. PROTOKOLLIT	DATA E MIRATIMIT
1	Rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete taksi	01-345/01-0008882/23	31.01.2023
2	Rregullore për transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës	01-345/01-0008883/23	31.01.2023

Nga numri i vendimeve dhe Rregulloreve të paraqitura, janë publikuar 71 prej tyre, kurse 5 Vendime nuk janë publikuar për shkak të kërkesave të Ministrive për rishqyrtim të tyre, si dhe ka raste që nuk janë publikuar për faktin se nuk ka kthim të vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrive në procedurën e shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA – KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë vitit 2023 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje, prej tyre 8 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Komiteti për Politikë dhe Financa që nga themelimi dhe konstituimi ka shqyrtuar të gjitha çështjet e propozuara për shqyrtim në Kuvendin e Komunës dhe për të njëjtat i ka rekomanduar Kuvendit sugjerime, propozime dhe ndryshime përkatëse, duke përfshirë pika shtesë apo edhe heqje të ndonjë pike teme të planifikuara për shqyrtim në Kuvend varësisht nevojave dhe kërkesave të paraqitura.

Në vijim paraqiten konstatimet e rekomanduara nga mbledhjet e KPF-së:

Më 30.01.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 31 janar 2023.

Fillimisht, pas diskutimeve rreth propozimit të z.Haki Rudarit në emër të subjektit politik LVV, nga 9 anëtar sa ishin prezent, me 5 vota Për, (të tjerët nuk votuan) mbështetet që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet edhe pika shtesë, dhe atë:

- Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100C për vitin 2023.

1.Propozim Rregullorë për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi -Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2.Propozim Rregullorë për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3.Propozim Vendim për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4.Kërkesa-Nisma e procedurës për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunave; Prishtinë, Podujevë, Lipjan, Fushë Kosovë, Graçanicë dhe Obiliq

- Propozim vendim për miratimin e Nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal

- Propozim vendim për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin përkatës të bashkëpunimit ndër-komunal - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5.Propozim Vendim për shpalljen në interes publik - pronat që preken nga projekti për ndërtimin e rrugës lidhëse nga magjistralja Prishtinë-Podujevë deri te rruga “Vëllezërit Frashëri” - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

6.Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive në Qytetin e Podujevës - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

7.Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike - Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

8.Propozim Vendim për ngritjen e komisionit përzgjedhës - për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo – arsimore - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

9.Propozim Vendim për destinimin e paluajtshmëris për ndërtimin e Qendrës Multifunktionale - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

10.Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Programi Trevjeçar i Banimit 2023-2025 - Njëzëri me 6 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja e konsultimi publik të jetë nga data 06 shkurt 2023 deri më 08 mars 2023, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 15 shkurt 2023, nga ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

11.Propozim Vendim për vënie në diskutim publik draft Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja e konsultimi publik të jetë nga data 06 shkurt 2023 deri më 08 mars 2023, ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 22 shkurt 2023, nga ora 17:00 në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

12.Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Barazi Gjinore (pas dhënies së dorëheqjes së znj.Drita Pajazitit për shkak të emërimit anëtare në KPF) - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, me propozim që në vend të ish anëtares znj.Drita Pajazitit në Komitetin për Barazi Gjinore të jetë znj.Lirika Muliqi

13.Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për diskutim të Raportit të punës së Kuvendit të komunës për vitin 2022, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

14.Falja e tatimit në pronë për qytetarët e Komunës së Podujevës në vlerë deri në 100€ për vitin 2023 - Njëzëri me 5 vota Për, (nga anëtarët që ishin prezent në sallë) i rekomandohet Kuvendit për diskutim rreth gjetjes së mundësive për faljen e tatimit në pronë në vlerë deri 100€ për qytetarët e Komunës së Podujevës për vitin 2023

Më 06.04.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 07 prill 2023

1.Propozimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 - Raporti nga diskutimet publike - Me 6 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 - Raporti nga diskutimet publike sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2.Propozim vendim për vënie në diskutim publik të Draft Planit të Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027 - Me 5 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 1 votë të Përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të Draft Planit të Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027.

3.Propozim programi tre vjeçar i banimit 2023-2025 – Raporti nga diskutimi publik / Debatit publik lidhur me programin tre vjeçar të banimit - Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim programi tre vjeçar i banimit 2023-2025 – Raporti nga diskutimi publik / Debatit publik lidhur me programin tre vjeçar të banimit

4.Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022 - Me 6 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022.

5. Propozim Plani i Punës së Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi 2023 - Me 5 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Kërkesë nga Qendra gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës - Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Kërkesa nga Qendra Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës.

Më 12.05.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 15 maj 2023

Fillimisht pas procesit të votimit me 8 vota Për, 0 vota Kundër dhe 1 votë të Përmblajtur u aprovua që në kuadër të rendit të ditës së KPI-së, të përfshihet Kërkesa e Klubit Politik “Afrim Zhitia”, të proceduar nga Kryesuesi i Kuvendit – Komitetit që ish znj. eurodeputete Dorisack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe të bëhet emërtimin i një rruge kryesore me emrin e saj.

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore - Me 5 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 1 votë të Përmblajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozimi vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, përfshirë edhe propozimin e z.Naim Çimaku që 20,000.00€, nga programi Administratë Komunale, në shumë 360,000,983.42€, të barten në kodin buxhetor të Kuvendit të Komunës.

2. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokale afariste në Tregun e Qytetit - Me 8 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokale afariste në Tregun e Qytetit.

3. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokalet afariste në tregun e Qytetit - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokalet afariste në tregun e Qytetit, duke theksuar se emrat e anëtarëve të komisionit do të prezantohen në seancën e Kuvendit.

4. Propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokalet afariste në tregun e Qytetit, duke theksuar se emrat e anëtarëve të komisionit do të prezantohen në seancën e Kuvendit.

5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për vitin 2022 - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtur i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

6. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2023 - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

7. Informatë e punës për vitin 2022 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Podujevës - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

8. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në

Komunën e Podujevës 2023-2025 - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

9.Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Planit i veprimt për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Planit i veprimt për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

10.Raporti informues i ecurive të punës në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

11.Raporti i Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën janar-prill 2023 - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

12.Kërkesa e Klubit Politik "Afrim Zhitia" që znj.eurodeputete Dorisc Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe emërtimin e një rruge kryesore me emrin e saj - Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmblajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim Kërkesa e Klubit Politik "Afrim Zhitia" që ish znj. eurodeputete Dorisc Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe të bëhet emërtimin i një rruge kryesore me emrin e saj.

Më 27.06.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 29 qershor 2023

Fillimisht pas procesit të votimit unanimisht u mbështet propozimi që për seancën e radhës në kuadër të rendit të ditës të sjellët edhe propozimi për pagesën e kompensimit e anëtarëve të Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës. i ngritur me vendimin nr.prot.01-020/04-0101084/22 datë 09.12.2022

1.Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për periudhën 2024 – 2026 - Nga 9 anëtarëje të KPF-së, me 6 vota PËR (të tjerët nuk morën pjesë në votim) i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2.Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore - Nga 9 anëtarëje të KPF-së, me 6 vota PËR (të tjerët nuk morën pjesë në votim) i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3.Propozim Vendimi për faljen e obligimeve të krijuara / borxheve nga qiratë në Tregun e Qytetit të Podujevës - Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhje.

4.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. "Skënderbeu"

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen dhe me korrigjimin e nenit I të këtij të këtij propozimi dhe atë, në pjesën e fundit pjesa ku thuhet "...Tregun e Qytetit, të fshihet..." .

5.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

6.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

7.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Njëzëri me 8 vota PËR, (nga anëtarët sa ishin prezent në sallë), i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe formimin e Komisionit në fjalë me emrat e anëtarëve që do të propozohen.

8.Propozim Vendimi për zëvendësimin e anëtarit të FSK-së në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB në Podujevë.

Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

9.Draft Plani i Integritetit 2023 – 2027 për Komunën e Podujevës - Njëzëri me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Më 28.07.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 31 korrik 2023

1.Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB, për 2022 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë) Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

2.Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Podujevës, për vitin fiskal 2022 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 9 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

3.Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periudhën Janar – qershor 2023 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 9 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

4.Propozim Vendimi për transferim të buxhetit të komunës për vitin 2023 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

5.Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me mekanizëm bujqësor” - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

6.Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri buxhetor për projektin “Furnizim me sera” - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

7.Propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 3 vota të Përmbajtura, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

8.Informatë e Drejtorisë së Arsimit për vitin shkollor 2022-2023 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

9.Propozim Plani komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023 – 2025 - Raporti nga konsultimi publik - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

10.Propozim Plani i veprimt për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 - 2026 në Komunën e Podujevës - Raporti nga konsultimi publik - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

11.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokal afariste në qytet rr. “Skënderbeu”

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

12.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00495-4 Lupç i Poshtëm

- Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

13.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00202-1 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

14.Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Prona e Paluajtshme tokë bujqësore nr.00209-0 Lupç i Poshtëm

-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023.

15. Propozim Vendimi për vënie në konsultim publik Draft Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare QKMF- Komuna e Podujevës - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njësëri me 9 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar të mbahet më 31.07.2023, kohëzgjatja dhe data e konsultimeve publike të caktohen në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Më 26.09.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 27 shtator 2023

Fillimisht pas procesit të votimit njëzëri mbështeten propozimet e paraqitura nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe financave z.Fatlum Osmani që të përshihen në kuadër të rendit të ditës si pika shtesë dhe atë:

-**Propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së) -** Njësëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.

-**Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri për projektin “ Furnizim me mëshqerra “ -** Me 6 vota për, asnjë votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.

-**Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës -** Njësëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.

-**Propozim vendimi -** materiali nga pika e 9 e rendit të ditës për shkak të një gabimi teknik të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026 & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026 - Njësëri, përkatësisht me 9 vota u miratua propozimi -që propozim vendimi - materiali nga pika e 9 e rendit të ditës të tërhiqet dhe zëvendësohet me propozim vendimin për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje – draft Strategjia dhe Plani i veprimit lokal për dhunën në familje 2023-2026.

-**Kryesuesi i Kuvendit propozoi që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naille Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkolli -** Njësëri, përkatësisht me 9 vota për rekomandohet të përfshihet si pikë e rendit të ditës sipas renditjes së pikave të rendit të ditës së KPF-së.

1. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore 2025/2026 - Njësëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

2. Propozim Vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri - Me 5 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

3. Propozim Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 - Me 6 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

4. Propozimi i Statutit të QKMF - Raporti nga diskutimi publik - Me 6 vota për, asnjë votë kundër, asnjë votë të përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

5. Propozim Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027& Raporti nga diskutimi publik - Njësëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

6. Informatë për përgatitjet për fillimin e vitit shkollorë 2023-2024 - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

7. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të draft Planit Operativ Emergjent Lokal- POEL & draft Plani Operativ Emergjent Lokal- POEL - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

8. Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë dhe Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje & draft Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2026 –Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit – shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës (Në procedurë të rishqyrtimit sipas kërkesës nr. 020-586/4 datë 24.07.2023 të MPL-së) - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

10. Propozim vendim për shtim të buxhetit dhe kod të ri Për projektin“ Furnizim me mëshqerra” - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

11. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në territorin e Komunës së Podujevës - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

12. Plotësimi i përbërjes së anëtarëve të Komitetit për Komunitete me një anëtarë/e nga radhët e komunitetit ashkali, dhe atë në vend të znj. Naile Ahmeti, nga komuniteti ashkali nominohet znj. Fikmete Qurkollli - Njëzëri, përkatësisht me 9 vota për i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

Më 27.10.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 31 tetor 2023

Fillimisht, pas diskutimeve, njëzëri me 8 vota Për nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështetet propozimi i anëtarës së Kuvendit të Komunës dhe këtij Komiteti znj. Drita Pajaziti, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë,

-Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi.

Me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbytur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi i Ekzekutivit të Komunës, i paraqitur nga z.Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë edhe,

-Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale - “Eko-Llapi” Sh.A.

1. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e Draft Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024 - Me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbytur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Propozim vendimi për vënien në konsultim publik Draft Planin Lokal i Veprimit për Barazi dhe Diskriminim në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2026 - Me 5 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbytur, (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Marrja e vendimit për lirim nga taksa për mamografi - Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të mundësive për lirim pa pagesë nga taksa komunale e kontrolleve shëndetësore të mamografisë në QKMF – Podujevë.

4.Propozim vendimin për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale – “Eko-Llapi” Sh.A. - Me 6 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të përmbajtur (të tjerët nuk votuan). Kuvendit të Komunës rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për diskutim dhe shqyrtim të kësaj pike sipas materialit të prezantuar në këtë mbledhje.

Më 22.11.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 23 nëntor 2023

-Propozim vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Pas diskutimeve, Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështetet Propozim vendimi në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për datën 23 nëntor 2023.

Më 06.12.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 08 dhjetor 2023

1.Propozim vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023 - Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, mbështetet Propozim vendimi në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për datën 08 dhjetor 2023.

2.Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. “Llapi 1932” SH.P.K. Podujevë. - Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, mbështetet kërkesa e propozuar për ndarje të shumës 20.000.00C udhëimë / subvencion për Klubin e Futbollit K.F. “Llapi 1932” për ushtrimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e garave në Albi Mall Superligën e Kosovës, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e caktuar për datën 08 dhjetor 2023.

Më 27.12.2023 - KONSTATIME të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 28 dhjetor 2023

Fillimisht, pas diskutimeve, njëzëri me 9 vota Për, mbështeten propozimet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pikë shtesë, dhe atë:

-Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndërkomunal Shumë-Funkcional (e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit)

-Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Podujevës (përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025)

1.Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2.Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare (ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022) - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3.Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023 - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit që raportimi në fjalë të bëhet në mbledhje e radhës të datës 28.12.2023

4.Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

5.Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal – (Raporti nga konsultimi publik) - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6.Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndërkomunal Shumë-Funakisonal (e lidhur mes 6 Komunave dhe atë: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqi) - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit të thirrur për datën 28.12.2023 (bashkëngjitur Marrëveshja në fjalë)

7.Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave për Komunën e Podujevës (përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025) - Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët e pranishëm i rekomandohet Kuvendit për rishqyrtim sipas kërkesës së MMPHI, konkretisht për përfshirjen e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2025, kurse pjesët tjera të Planit mbeten të pandryshuara nga dokumenti i miratuar më 27.09.2023.

Kuvendi i Komunës së Podujevës, përveç Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe Komitetit për Komunitete si trupa të përhershëm të Kuvendit, me qëllim të funksionimit sa më efikas të Komunës, ka të themeluara edhe Komitetet dhe Komisione-trupa tjera, ndër më të rëndësishmet:

-Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

-Komiteti për Barazi Gjinore

-Komiteti për Zhyllim Ekonomik

-Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale

-Komisionet Komunale të Aksionarëve të tri (3) Ndërmarrjeve Publike (Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a; Ndërmarrja Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë; Ndërmarrja Publike për Banim sh.a. Podujevë; Ndërmarrja Publike "Eko-Llapi)

-Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e komunës së Podujevës.

-Anëtarët e caktuar përfaqësues të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës

Podujevë,
Janar 2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Raporti i punës së Komisionit Ad-Hoc për shikimin, analizimin dhe
vlerësimin e dokumentacionit të të dëmtuarve nga breshëri gjatë vitit
2022**

Shkurt 2024

Hyrje

Bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës të datës 28.12.2023, me nr protkoli: 01-020/04-0000047/24, për themelimin e Komisionit për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 sipas rekomandimit nr.prot.02-016/01-0086038/23 të datës 06.12.2023 dhe listës përkatëse të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmëve nga fatkeqësitë natyrore tjera, Komisioni në përbërje prej :

- 1. Ekrem Rrahmani**
- 2. Ragip Fetahu**
- 3. Bashkim Syla**
- 4. Burim Hasani**
- 5. Edona Shabani**

Ka shqyrtuar dokumentacionin e ofruar dhe në mbledhjen e mbajtur më 07.02.2024 të komisionit të themeluar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, janë konstatuar këto probleme në dosjet e bujqëve që pretendojnë se janë dëmtuar nga breshëri;

Të gjeturat e komisionit

1. Në dosjet e aplikantëve mungojnë raportet e vlerësimit të komisionit komunal si dhe procesverbalet e terrenit;
2. Në raportet e komisionit komunal nuk ka përputhje të sipërfaqes së dëmtuar me atë që kanë deklaruar bujqit në kërkesën e tyre me shkrim (P.sh. Rasti i H. K. në kërkesën e fermerit janë të deklaruara tetë ari kultura të dëmtuara, kurse në raportin e komisionit vlerësues kjo vlerë është rrit në 0,80 ari). (Sipas Raportit refuzues të Ministrisë).
3. Nuk ka përputhje të përqindjes së dëmit nga breshëri ndërmjet procesverbalit të terrenit dhe raportit të vlerësimit (Sipas refuzimit të Ministrisë).
4. Te një pjesë e dosjeve mungojnë fotot dhe dëshmitë tjera të dëmit të shkaktuar nga breshëri.

5. Dy kërkesa nga i njëjti bujk në data të ndryshme për të njëjtën kulturë të pretenduar që është dëmtuar, por me rritje të sipërfaqes.
6. Një raport i vetëm i hasur në një dosje, por jo i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues.
7. Përdorimi i të njëjtave fotografi nga disa aplikant.
8. Komisioni ka konstatuar se nga 36 fermerët në listë, 16 prej tyre figurojnë se janë kompensuar Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural.
9. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha dosjet e fermerëve të pretenduar se janë të dëmtuar, janë **Refuzuar** Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural

Bazuar në të gjeturat gjatë punës së komisionit dhe pajtimit unanim të anëtarëve të komisionit, komisioni i rekomandon Kuvendit Komunal të Podujevës si vijon:

Rekomandimet

- Lista e fermerëve të trajtohet si tërësi pavarësisht vendimit të anëtarëve të Kuvendit (Refuzues apo Pozitiv)
- Të ipen vërejtje me shkrim komisionit vlerësues komunal për shkak të lëshimeve teknike të bëra gjatë punës në teren.

Procesverbal i mbledhjes së komisionit

Bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të datës 28. 12. 2023 është takuar komisioni i propozuar. Mbledhja u mbajt më 07.02.2024 dhe filloi në ora 10:10 duke respektuar ligjin dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës.

Në takim ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit; Ekrem Rrahmani , Edona Shabani, Ragip Fetahu, Burim Hasani dhe Bashkim Syla.






Në fillim u zgjodh në mënyrë unanime kryesuesi i Komisionit z. Ekrem Rrahmani. Pastaj, u soll dokumentacioni i fermerëve nga personi kompetent.

Në prezencë të të gjithë anëtarëve të komisionit u bë hapja e dosjeve të të gjithë bujqve që kanë aplikuar për kompenzim të dëmit nga breshëri .

Gjatë verifikimit të dosjeve janë gjetur disa mangësi dhe shkelje, të cilat do të pasqyrohen në raportin e komisionit në Kuvend.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në ora 15:10.

Anëtarët e komisionit;

Ekrem Rrahmani 
Ragip Fetahu 
Bashkim Syla 
Burim Hasani 
Edona Shabani 

Procesverbalin e mbajti

Ragip Fetahu

Më 07.02.2024